REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1121/20
Datë/Datum. 21.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-20-3417-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i Institucioneve arsimore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

VLERA SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

12 Qershori,Shtime
(Adresa)

Shtime — *(Vendi)*
72000 — *(Kodi postar)*

044-287-776 — *(Numri Telefonit)*
(Numri i Faks-it)

Mufail Salihaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

vlera.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

Dezinfektim-Dezinsektim-Deratizim PEST CONTROL & HYGIENE VLERA SH.P.K. SHTIME

19.12.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1.Me daten 06.07.2020 eshte publikuar njoftimi per kontrate.
3.Afati i fundit i dorezimit te ofertave, deri me 27.07.2020
3.Hapja e ofertave po te njejten date: 27.07.2020
4.Vendimi i pare i AK :12.08.2020 (rekomandomi per kontratë VLERA SH.P.K.
5.Vendimi i dyte i AK:15.10.2020 (rekomandohet per kontrate Besim A. Zejnullahu,me cmimin me te larte.
6.Vendimi i tret i AK 22.10.2020 Vendimi sipas kerkeses per rishqyrtim Aprovohet kerkesa OE:VLERA SHPK
7.Njofitmi mbi vendimin e AK:30.10.2020 Anulon Aktivitetin e prokurimit
8. Vendimi sipas kerkeses per rishqyrtim 03.11.2020
9. Njofitmi mbi vendimin e AK:03.12.2020 Anulon Aktivitetin e prokurimit
10. Kerkeses per rishqyrtim 07.12.2020
11. Vendimi sipas kerkeses per rishqyrtim me date 10.12.2020 AK na refuzon kerkesen per ri-shqyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 72 : Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 1: Qellimi
Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59: Egzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve.
Neni 69: Aftesia teknike dhe profesionale.
Neni 60: Kriteret per dhenje te kontrates.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 12.08.2020 ishim shpallur fitues te kesaj Kontrate ku pastaj pas ankeses se nje OE lenda shkoj ne OSHP dhe u rikthye ne Rivlersim. Pas shume shpifjeve qe kishte bere OE Besim A Zenjullahu B.I duke pohur se shumica e dokumentacionit qe kishim ofruar ne ishin Fiktive perfshire fatura,kontrata,listen e puntoreve,msds etj asnjera nga pohimet e tij nuk u dolen te sakta pas vertetimit edhe nga ana e OSHP, ATK-së edhe nga ana Komunes se Prishtines,.

AK me daten 09.10.2020 ,kerkoj sqarime shtes nga ne duke na kerkuar kontrata dhe transaksionet bankare , si dhe te sqaronim pse ishte e vendosur nje date dhe nje titull ne njeren prej faqeve te MSDS. Ne në po kete datë 09.10.2020 menjehere dorezuam sqarimet shtese , ku me daten 15.10.2020 morren Vendimin per Eleminim.

Ne kete vendim, shkruhej se u eleminuam per arsye se ne njeren prej faqeve te MSDS kishim shkruar daten e skadimit dhe Titullin e Certifikates. Ne e kemi cekur edhe tek sqarimet shtese : Sqarimi: Sa I perket dokumentit te MSDS NR. 100057 I njejti mund te shkarkohet nga internet nga secili person I interesuar per to sepse eshte deklarate qe leshohet nga prodhuesi qe tregon perberjen kimike dhe sigurine e produktit

.Me që ne dosjen e Tenderit , Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME (faqe 17 e dosjes)eshte kerkuar që : Preparatet Deratizuese duhen të kenë: - Çertifikatë të A-Testit , - Afat të përdorimit.

Ne duke je permbajtur kerkeses se dosjes se tenderit qe te ceket afati (skadenca) e produktit tonë, ne fund te faqes se MSDS kemi shenuar daten e skadimit te produktit tonë duke ju permbajtur kerkeses se dosjes se tenderit.(Pasi qe ne dokumentin e MSDS nuk ceket kjo date ne e kemi shkruar sepse ne qoftese do te mungonte ne do te eleminoheshim qe se kemi cekur daten)

Sa per sqarim ky produkt eshte ngjitës i minjëve që eshte vetem njëri nga dhjetra produkte qe ne i perdorim per Deratizim , dhe kjo datë as nuk e zbehë kualitetin e produktit dhe as nuk e konteston produktin ne fjalë,por vetem e bene transparentë daten e skadences se produktit.

AK ne vendim ka thene qe ne kemi ndërhyrë ne kete Specifikacion te Produktit duke mos qene ne dijeni qe ata **vete kanë kerkuar qe te shenohet data e skadimit te produktit**.(lexo Aneksin 1 te dosjes)

Cila do te ishte arsyeja qe ne te benimin nderhyrje ne kete dokument te specifikimit te produktit , sepse kjo nuk na shpije askund. Ne nuk mund te i nderrojm specifikat e produktit sepse ato jane kerkuar qe te dorezohen te tilla cfardo qe jane , në qoftese ne do ti ndryshonim ndonje specifike produktit vetem qe ti pershtateshim specifikacionit teknik atehere do te kishte ndonje arsyeje per eleminim. Por jo qe eshte shkruar data dhe

titulli.
Arsyeja e eleminimit eshte shume absurde sepse ne kemi ofruar te gjitha dokumentet e kerkuara ne dosje dhe askund ne asnje ligje apo udhezim administrative nuk ceket qe ne nuk guxojm te shenojm daten e skadimit te produktit,**mbi te gjitha kur eshte kerkuar nga vete Dosja e tenderit** , te **specifikacioni teknik**.
Dmth ne vetem ju kemi permbajtur dosjes se tenderit , kurse Komisioni i vleresimit nuk e ka marre per bazë fare qe në dosje ata vete e kane kerkuar qe te ceket afati i perdorimit. AK ka bere shkelje te nenit 1,6,7,59 te LPP duke mos vlersuar drejt tenderin tonë.

Pas Kerkeses per Rishqyrtim ne me daten 3.12.2020 kemi pranurar Vendimin per tenderuesit e eleminuar , ku arsyeja e
eleminimit ishte per Msds,dhe Certifikaten e Analizave, ku AK pretendon qe ka pas nderhyrje ne keto dokumente.
Me kete vendim AK nuk eshte ne harmoni me
Nenin 72 , Dokumentacioni dhe informacioni shtesë ku thote :
Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
Ne qoftese AK mendon qe keto dokumente te produkteve jane te mangeta ose nuk i plotesojn kerkesat e tyre atehere do te duhej qe te ftoheshim qe ti plotesonim ato.
Ne nuk kemi marrur asnje ftese nga AK qe ti plotesojm dokumentet e tilla , duke pasur parasysh qe kemi qene tenderuesi me cmimin me te lire ku perveq plotesimit te kritereve per dhenjen e kontrates ata do te kursenin buxhetin e tyre respektivisht do te jene ne harmoni te plote me Nenin 6 te LPPK.
Sa i perket tenderuesit tjeter Besim Zenjullahu B.I qe ne vendimin e fundit eshte eleminuar pasi qe ne si OE e kemi gjetur se ka pasur Certifikaten e Analizave te falsifikuar , i njejti Operatori Ekonomik qe 5 vite rradhazi e merr kete tender me po te njejtin Certifikate te analizave te produktit qe AK ne vendimin e fundit e eleminoj pasi qe ne ja vertetuam nje gje te tille.
Per kete duhet ta jap pergjegjesi dikush sepse i njejti tenderues kishte shpifur dhe e dergoj kete lend ne **OSHP me numer 598/20,**kur ishim shpallur fitues dhe nga pa pergjegjesia e OSHP kjo lend u kthye ne rivlersim .
Ne ne OSHP patem dorezuar dokumente shtese per shpifjet qe kishte bere Besim Zenjullahu qe per OSHP nuk i kishte lexuar sepse eksperti shqyrtues deklaroj se i kishin ardhur me vonese,edhe pse ne i derguam menjeher ne arkiven e oshp.
Kerkojm nga OSHP dhe eksperti shqyrtues qe kete procedure te prokurimit ta kthejn ne Rivleresim dhe te kerkohet nga ne qe te bashkangjitet- plotesohet dokumenti i MSDS sepse kompania jone zotron dhjetra te tilla pasi qe jemi distributor gjeneral i pesticideve dhe biocideve per shume brende boterore dhe secili produkt qe ne zotrojm ka MSDS, Certifikaten e analizave etj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

1. Shkeljet e supozuara kane shkaktuar demtim te imazhit te kompanise tone, kur merret parasysh afarizmi shumevjeqar i kompanis sone ne kete lemi. Gjthëashtu na eshte shkaktuar dem marial-financiar. Shpenzimet arrijn vleren e 15,000.00 euro
2. Humbja e vendeve te punes per disa punetor qe per momentin jane te angazhuar dhe do ta shtonim numrin e puntorve ne rast qe kjo kontrate do te ishte nenshkruar
3. Humbja e tregut per punet qe do t'i ofrojme ne rast qe do ishim shpalle fitues

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë
h) Kërkesë për rishqyrtim AK PRISHTINE (1) 19.10.2020
i) Kërkesë për rishqyrtim AK PRISHTINE (2) 07.12.2020
j) Vendimi per rishqyrtim Vlera 10.12.2020
k) B47 Leter Sqarimi AK PRISHTINE - vlera shpk
l) VENDIMI I AK-së 03.12.2020

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*